URDHËR
Nr. 165 datë 12.3.2020

PËR MBYLLJEN E KABINETEVE/KLINIKAVE DENTARE
(Ndryshuar me urdhrin nr. 221, datë 1.4.2020)
(i përditësuar)

Në zbatimi të nenit 7, pika 4 të ligjit Nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", ligjit nr 9106 datë 17.07.2003 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë" me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e kabineteve/klinikave dentare, në të gjithë vendin *deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019*.
2. Rastet e urgjencave stomatologjike të trajtohen në Klinikës Stomatologjike Universitare pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe në institucionet stomatologjike publike që do të funksionojnë vetëm për shërbimin e urgjencës stomatologjike.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri.
4. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu